

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FOTO- Ndodh për herë të parë/ 55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjalën e gjallë pas një dite
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/ndodh-per-here-te-pare-55-vjecarit-i-nxjerrin-nga-barku-n-gjalen-e-gja-i105693
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:00:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 18:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b832a17e9ccfb2fd9185b392443633b9d2f3133fe824959750f0feba3d82e60c
TEKSTI	47aa76fa3f56e7e282b96ac094ab7ebc52f23dda025b33c807eba4f10510ed49
PAMJA	4680879165504549a5d51ee3fb1d359b93b5b7a6681b6fcc073eeb126ee2267f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0ab96278aadb718b80a265b712c4cdb261295d8b7cfff2789078151d0cda96d48
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0ab96278aadb718b80a265b712c4cdb261295d8b7cfff2789078151d0cda96d48>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

**për
akuzat**

perqendronemi
te problemi
yt... Të gjithë
ne Do të

**është bosi
shqiptar i**

suspiar
dhe i
konsideruar
nga SPAK

**strukturuar
kriminal**

ist-
drejtoreshën
e S...

**do të bjerë
si tigër prej**

k&e...

**Ja kë po
përpiqet të**

e Shtetit, Vlorë
H...

AKTUALITET

FOTO- Ndodh për herë të parë/ 55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjalën e gjallë pas një dite

Piranjat Përditësimi i fundit 23 Shtator 2026, 20:05



Mjekët mbetën të shtangur nga një burrë që u paraqit në urgjencë një ditë pasi një ngjalë i ishte futur "aksidentalisht" në anus.

55-vjeçari, i cili ishte peshkatar, fillimisht nuk kërkoi ndihmë mjekësore, pasi shpresonte që krijesa të dilte përsëri "vetë". Por ai shkoi në spital pasi filloi të përjetonte dhimbje të forta abdominale.

Rrezet X treguan se ngjala kishte shpuar zorrën e trashë të burrit pasi kishte hyrë në trup përmes rektumit, duke shkaktuar peritonit. Ky është një infeksion i shtresës së brendshme të barkut, i cili mund të jetë kërcënues për jetën nëse nuk trajtohet.

Duke pasur frikë se burri mund të zhvillonte septicemi, mjekët e dërguan me urgjencë në sallën e operacionit për të hequr ngjalën, e cila ishte më shumë se 60 centimetra e gjatë dhe, çuditërisht, rezultoi se ishte ende gjallë.

Mjekët nga Bangladeshi e përshkruan rastin si një "rast unik të perforimit traumatic të zorrës, të shkaktuar nga hyrja aksidentale e një ngjale në rektum", në International Journal of Surgery Case Reports.

"Gëlltija ose futja e objekteve të huaja nuk është e pazakontë, veçanërisht të njerëzit që merren me profesione ose aktivitete të caktuara rekreative", vunë në dukje mjekët.

"Megjithatë, depërtimi i murit të zorrës nga një kafshë e gjallë, siç është një peshk, është një ngjarje e pazakontë dhe e dokumentuar shumë rrallë."

Pacienti ishte një peshkatar nga Bangladeshi. Në momentin e incidentit, ai kishte veshur një lungi, një lloj veshjeje të gjatë që përdoret shpesh nga burrat në Bangladesh.





55-vjeçari kishte përjetuar dhimbje të forta barku për rreth pesë orë kur u paraqit në urgjencë.

Mjekët vunë re se barku i tij ishte i fryrë dhe i ndjeshëm.


Ata kryen një radiografi, e cila zbuloi një hije në formën e një ngjale në anën e djathtë të barkut.

Skanimi tregoi gjithashtu një hije në formë gjysmëhëne poshtë pjesës së djathtë të diafragmës, shenjë që sugjeronte se ai kishte zhvilluar peritonit.

Peritoniti zakonisht shkaktohet nga një infeksion bakterial ose fungal, por mund të zhvillohet edhe kur lëngjet nga organe të tjera rrjedhin në peritoneum, membrana që vesh pjesën e brendshme të barkut dhe legenit.

Nëse nuk trajtohet shpejt, peritoniti mund të çojë në një infeksion kërcënues për jetën, i cili mund të përhapet me shpejtësi në të gjithë trupin.

Mjekët përcaktuan se pacienti ishte në rrezik të zhvillonte septicemi, ose helmim të gjakut – gjendje në të cilën mikrobet pushtojnë qarkullimin e gjakut – ndaj vendosën ta operonin menjëherë.





Ata nxorën ngjallën nga zgavra peritoneale e burrit, hapësira që rrethon organet e barkut dhe është e veshur nga peritoneumi.

Çuditërisht, ngjala, e cila ishte rreth 67 centimetra e gjatë, ishte ende gjallë.

Mjekët thanë se ajo kishte mundur të vazhdonte të merrte frymë duke shpuar murin e zorrës së trashë të burrit dhe duke kaluar në zgavrën peritoneale, e cila përmban një lëng, kryesisht ujë, që redukton fërkimin mes organeve.

Katër ditë më vonë, burri nuk kishte më simptoma dhe u largua nga spitali.

Raporti nuk përmend nëse ai kishte nevojë për kontrolle të mëtejshme mjekësore.

Mjekët përfunduan: "Ky rast thekson nevojën për vigjilencë në identifikimin e shkaqeve të pazakonta të dhimbjes abdominale, veçanërisht te personat që kanë ekspozime të lidhura me profesionin ose aktivitetet rekreative."

Mjekët e NHS-së në Britani nuk janë të panjohur me raste të ngjashme. Sipas analizave të të dhënave, rreth 400 objekte të huaja nxirren çdo vit nga rektumi i britanikëve.

Njerëzit më së shpeshti fusin objekte në rektum për kënaqësi seksuale.

Kjo lidhet pjesërisht me numrin e madh të nervave në anus, duke e bërë atë një zonë shumë të ndjeshme.

Por kjo praktikë, e njohur edhe si lojë anale, mbart një sërë rreziqesh – nga ngecja e objekteve brenda trupit deri te perforimi i zorrëve, i cili mund të jetë fatal, pasi përmbajtja e traktit tretës mund të rrjedhë në pjesë të tjera të trupit dhe të shkaktojë infeksion. /**PiranjatNews**/

Galeria fotografike ()



Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 23 Shtator19:35

[Të dielën ‘Tiranathlon’/ Ja rrugët ku do të kufizohet qarkullimi dhe linjat urbane që do devijojnë](#)

Tirana do të presë "Triathlon", sporti që bashkon tre disiplinat sportive më të njohura dhe të praktikuara në një...

AKTUALITET 23 Shtator19:22

EMRI/ I maskuar, i riu shqiptar shpërndante dy lloje droge! Grupi në WhatsApp i “shtoi telashet”

Një shpërndarës droge i maskuar si korrier i kompanisë “Just Eat” u kap nga policia teksa shpërndante lëndë narko...

AKTUALITET 23 Shtator19:12

16 vite nga zhdukja misterioze/ SPAK: Nuk rezulton të ketë çështje të regjistruar për Bleona Matën

Prej disa ditësh është rikthyer në vëmendje çështja e Bleona Matës, e cila prej 16 vitesh rezulton e zhdukur. Sot n&eu...

AKTUALITET 23 Shtator19:12

Priste trenin me të dashurën, i arratisuri nga Shqipëria prangoset në stacion

Një burrë shqiptar, ndaj të cilit ishte lëshuar një urdhër arresti ndërkombëtar, po priste me qetësi një tren ...



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.